

Këshilli ekzekutiv i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë (LSHPM) më 9 tetor 2018 mbajti një seancë të zgjeruar në të cilën përveç anëtareve të KE morën pjesë edhe: Besnik Pocesta, kryetar i Kuvendit të LSHPM, Mitre Stojanovski, kryetar i Këshillit mbikëqyrës, Gjorgji Trpçevski, kryetar i KE të SHP Ohër dhe Debërcë dhe Ilija Gligorov - anëtarë të delegacionit të LSHPM të Festivalit ndërkombëtar të gjeneratës së tretë në Lubjanë, Zdravko Petkovski, kryetar i komisionit për sport dhe rekreacion të LSHPM, Pero Andreevski dhe anëtarë të tjerë të shërbimit profesional të LSHPM. Me seancën e zgjeruar të Këshillit ekzekutiv, e 19-ta me radhë gjatë këtij mandati, udhëhoqi kryetari Dragi Argirovski.

Fillimisht u shqyrtuan Propozim-raporti financiar për të ardhurat e realizuara dhe shpenzimet e kryera në periudhën prej 01.01 deri 30.6.2018 dhe raporti i Këshillit mbikëqyrës për të cilin përmbledhje hyrëse dha kryetari i Këshillit, Mitre Stojanovski. Ishte vlerësuar që raporti financiar është i përpunuar me cilësi, ndërsa puna e Lidhjes pavarësisht aktivitetëve të rritura është racionale dhe me përgjegjësi. Raportet njëzëri u pranuan.

Raport për Garat e 23-ta sportive republikane të mbajtura në vi-

SEANCA 19 E KE I LSHPM

REZULTATET E PUNËS JANË MOHIM I LAJMEVE TË RREJSHME



tin 2018, parashtroi Zdravko Petkovski, kryetar i komisionit për sport dhe rekreacion të LSHPM. Sipas të dhënave të hollësishme dhe të sistematizuara u konkludua se Komisioni, Këshilli organizativ dhe nikoqiri i SHP Radovish dhe Konçe mirë e kanë mbaruar punën, ndërsa rezultat i saj është realizimi i Garave të 23-ta republikane sportive në të cilat fjalim rasti kishin kryeministri, Zoran Zaev dhe ministrja e PPS, Mila Carovska.

Informacion për pjesëmarrje të LSHPM në Festivalin e 18-të ndërkombëtar të Gjeneratës së tretë në Lubjanë - Slloveni, në vitin 2018, paraqiti Dimitrija Bogatinovski, anëtar i KE të Lidhjes dhe kryetari i SHP Solidarnost - Aerodrom, e cila udhëhoqi delegacionin e LSHPM, në përbërjen e të cilit ishin edhe Gjorgji Trpçevski, Ilija Gligorov, Risto Trajkovski. Dy shoqatat e motëruar, SHP Ohër dhe Debërca dhe SHP Solidarnost - Aerodrom

nga Shkupi, në këtë festival kanë përfaqësuar LSHPM përmes ansambleve folklorike të vetë shoqatave. Në fjalimin e tij Bogatinovski theksoi që dy shoqatat denjësisht i kanë përfaqësuar pensionistët nga Maqedonia, qytetin e Shkupit dhe Ohrit, si dhe trashëgiminë tonë të pasur kulturore. Për qëndrimin në Lubjanë u shpreh edhe Gjorgji Trpçevski, i cili e lavdëroi pritjen dinjitoze të delegacionit tonë dhe duartrokitjet e fuqishme nga ana e publikut, pastaj ju falënderua LSHPM-së për mundësinë e dhënë për pjesëmarrje në një ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare.

Në mbledhje, rend dite ishte edhe miratimi i qëndrimit për lajmet e rrejshme kundër LSHPM nga Mendo Dimovski në kolumnat e tija të botuara në gazetën "Sloboden Peçat", me të cilat shkakton dëme në imazhin e Lidhjes, për arsye se në to mohohen të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e arritura. (K.S.Andonova)

SHP SARAJ

Promovimi i librit "Kujtimet" nga Baki Bakiu

Me rastin e Ditës së Shoqatës 25 shtatori, më 28.09.2018, në Klubin e pensionistëve të Komunës së Sarajit, në prezencën e dhjetëra pensionistëve, u promovua libri me titullin "Kujtimet" nga autori Baki Bakiu. Fillimisht të pranishmit u përshëndetën nga ana e kryetarit të Këshillit ekzekutiv të Shoqatës Mahir Duraku, i cili mbi të gjitha theksoi se autori Baki Bakiu librin ka patur mundësi ta pro-



movojë në shumë institucione tjera, por jo rastësisht ai e ka zgjedhur ta bëjë atë për nder të Ditës së SHP Saraj. Pastaj moderatorja e takimit Sherife Dauti, i dha fjalën autorit Baki Bakiu, i cili e përshëndeti audiencën dhe i njoftoi shkurtimisht me detajet e librit: "Në prag të tetëdhjetave, kam konsideruar që është e duhur dhe e mirë që kujtimet e mia ti nxjerr në letër. Kujtimet i kam radhitur në mënyrë kronologjike, duke filluar nga fëmijëria, rinia, pjekuria dhe pleqëria, duke i krahasuar me katër stinët e vitit: pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër, dhe për këtë arsye në kopertinë kam vendosur një fotografi të stinëve të vitit të cilat na përkujtojnë në fazat e jetës së njeriut. Përveç teksteve, në libër janë vendosur rreth 60 fotografi, si dhe 12 këngë nga një autor i njohur, të cilat fuqishëm flasin për kujtimet e të kaluarës, që janë të vendosura në vende të përshtatshme. Në vazhdim të promovimit, moderatorja Sherife Dauti, lexoi disa tekste në prozë dhe poezi, përderisa autori Baki Bakiu e lexoi këngën e vendosur në fund të librit me titullin "Dua të vdes si meritur", e cila shkaktoi emocione të audiencës. (S.B)

SHP KUMANOVË

Takim i përzemërt në Likovë

Nazim Destani, kryetari i Degës së Likovës. Me fjalim rasti të pranishmëve ju drejtua edhe Spirko Nikollovski, kryetari i SHP Kumanovë, i cili me kënaqësi theksoi se në Shoqatë janë anëtarësuar mbi 15.000 pensionistë nga Likova, Kumanova dhe Nagoriçani i Vjetër. "Në Shoqatë janë anëtarësuar përfaqësues të të gjitha etniteteve, gjatë së cilës posaçërisht vjen në shprehje bashkësia dhe bashkëjetesa e pensionistëve", tha Nikollovski.

Në këtë takim të katërt është futur risi e takimit që të marrin pjesë edhe nxënësit e SHFQ "Dituria" nga Likova. Takimi kishte ka-

rakter inkluziv, me realizimin e një programi të përbashkët kulturo-artistik. Orkestri i mandolinave i shkollës interpretoi disa kompozime të njohura nën udhëheqjen e profesorit të muzikës. Disponimin e këndshëm muzikor-argëtues e ploëtsuan zërat e këngëve popullore të SHKA "Gjoko Simonovski": Kalina Boshkovska, Sllobodanka Dimkovska dhe Vlladanka Popovska, ndërsa i kanë shoqëruar orkestria e shoqërisë. Motin e bukur me diell pensionistët e shfrytëzuan edhe për të shëtitur dhe vizituar dy digat e akumulimeve artificiale: Likovë dhe Glazhnja dhe rrethina e tyre. (S.N)



Në një ditë tepër të bukur vjeshtore, më 10 tetor 2018 është mbajtur një takim multi-etnik i pensionistëve në Likovë. Në prezencë të qindra pensionistëve nga Kumanova, Llojani, Sllupçani, Likova, Mateçi dhe Llopati u mbajt një ceremoni rasti në restorantin "Panorama" në bregun e Digës së Likovës. Ceremoninë e hapi

FESTIVALI I 18 "GJENERATA E TRETË" NË LUBJANË

Maqedonia denjësisht e përfaqësuar nga pensionistët

Festivali ndërkombëtar "Gjenerata e tretë" në Lubjanë - Slloveni, i cili u mbajt me rastin 1 Tetorit - Ditës ndërkombëtare të personave të moshuar, është projekt i LSHPM dhe BE.

Festivali filloi me akademi solemne në sallën e madhe të Shtëpisë së Cankarit, në të cilën morën pjesë delegacione të lidhjeve të shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Kroacisë, Italisë, Serbisë, Austrisë, të nikoqirit Sllovenisë, si dhe përfaqësues të asociacioneve tjera të pensionistëve dhe organizatave joqeveritare të Bashkimit Evropian.

Në hapjen e akademisë solemne fjalim rasti kishte kryeministri i Sllovenisë, Marjan Sharec dhe kryetari i Lidhjes së pensionistëve të Sllovenisë Janez Sushnik, të cilët

kanë folur për të arriturat e deritanishme në kujdesin që ka Sllovenia ndaj personave të gjeneratës së tretë. Në fjalimin përshëndetës kryetari i pensionistëve të Sllovenisë, Sushnik dërgoi përshëndetje të përzemërta deri tek Dragi Argirovski, deri te LSHPM dhe pensionistët e Maqedonisë. Delegacioni ynë kishte takim të posaçëm me Jozhica Puhar, kryetarin e komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar të ZDUS dhe anëtar i Organizatës evropiane të pensionistëve të së cilës morën pjesë përfaqësuesit e shoqatave prezente në festival. Në takim Bogatinovski fillimisht përcolli përshëndetjet nga kryetari i LSHPM Dragi Argirovski dhe në pika të shkurta prezantoi LSHPM, ndërsa më pastaj foli edhe për SHP Solidarnost - Aerodrom.

Anëtar i delegacionit, kryetari i SHP Ohër-Debërcë, Gjorgji Trpçevski, me kënaqësi të veçantë falënderoi për pjesëmarrjen në këtë manifestim, i cili është i një rëndësie të veçantë jo vetëm për shoqatën nga Ohri, por edhe për afirmimin e Ohrit dhe Maqedonisë.

Në takim u soll konkluzioni që të zgjerohet bashkëpunimi mes lodhjeve të pensionistëve, por jo vetëm me vendet fqinje, por të përfshihen edhe lidhjet e pensionistëve nga ish republikat e Jugosllavisë, sepse aq më masovik të jemi aq më mirë dhe në mënyrë më efikase do të zgjedhim problemet tona. Në kuadër të festivalit "Gjenerata e tretë", tri ditë u mbajt edhe Panairi i prodhimeve, preparateve mjekësore, mjekimeve, preparateve ortopedike, ndërsa kishte



edhe këshillimore, edukime, matje të tensionit të gjakut dhe sheqerit në gjak, matje të shkallës së osteoporozës, shtangje të punimeve të vjetra të dorës, të punuara në kohërat e kaluara dhe shumë prodhime ushqimore për ushqim të shëndetshëm, material propagandistik për udhëtime turistike, dhe çka jo, ndërsa e gjithë kjo ishte e lidhur me personat e gjeneratës së tretë, vendosura në 60 shtangje.

Në festival morën pjesë 120 grupe muzikore dhe ansamble me 3000 muzicentë dhe folkloristë,

thujse nga e gjithë bota. LSHPM në festivalin "Gjenerata e tretë" në Lubjanë u prezantua në pjesën muzikore të programit të festivalit me SHKA "Solidarnost - Aerodrom" nga Shkupi dhe SHKA "Dallgi" pranë SHP Ohër-Debërcë edhe atë me tri pika shumë të suksesshme të përbashkëta. Folkloristët tanë nga Ohri dhe Solidarnost-Aerodrom u pranuan ngrohtë nga publiku prej mijë personash, të shoqëruar me ovacione. Në mesin e publikut të madh kishte edhe bashkëqytetarë tanë që jetojnë dhe punojnë në Slloveni. (K.S)